REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073515

Datë: 03.05.2019

Numri i dokumentit: 00298896

P.nr. 91/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me procesmbajtësen Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit F. S. nga Presheva, R.Serbi, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjitshëm, me numër PP.II.nr.14/2019, të datës 21.01.2019, jashtë seance dhe sipas detyrës zyrtare, me datën 03.05.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET poshtë aktakauza e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjitshëm me numër PP.II.nr.14/2019, të datës 21.01.2019.

II. PUSHOHET procedura penale ndaj të të pandehurit F. S. nga Presheva, R.Serbi, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës, për shkak se vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074.

III. Të dëmtuarit Xh. F. dhe E. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.01.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.14/2019, kundër të pandehurit F. S. nga Presheva, R.Serbi, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Duke pasur parasysh se Kodi i ri Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të datës 13.12.2018, i miratuar nga ana e Kuvendit i Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 14.04.2019, gjykata gjeti se veprimet inkriminuese të të pandehurit N. M., nuk përbëjnë vepër penale ngase sipas nenit 370 paragrafi 1 të KPRK-ës, thuhet se "*Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet",* çka nënkupton se veprimet të cilat kanë pasur si pasojë shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor të kryer me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo trasportit rrugor e të cilat kanë qenë të parapara edhe në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar më nuk përbëjnë më vepër penale, gjithashtu duke pasur parasysh se sipas nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-ës në të cilin thuhet se "*Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm",* si dhe faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykatës dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret veprimet inkriminuese të parapara në nenin 378 paragrafi 1 të KPRK-ës së shfuqizuar (pëkatësisht shkaktimi i lëndimit të lehtë trupor me rastin e shkeljes së ligjit mbi trafikun publik apo trasportit rrugor) sipas kodit të ri penal nuk paraqet vepër penale dhe si rrjedhoj ndaj kryesve të këtyre veprave penale më nuk mund të ndërrmiret ndjekja penale dhe të njejtëve tu shqiptohet ndonjë dënim i paraparë ligjor.

Andaj gjykata në bazë të nenit 253 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së dhe nenit 3 paragrafi 2 të KPRK-ës, vendosi që të hudhë poshtë aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit të lartcekur të pushohet procedura penale për veprën penale e cila i vihet në barrë.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.91/19, më datë 03.05.2019

Procesmbajtësja,
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.

2019:073516